



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

Nr. _____ prot.

Fier, më ____ . ____ . 2025

PLANI VJETOR

I GJIMNAZIT “PERIKLI IKONOMI”

PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

Plani vjetor i gjimnazit “Perikli Ikonimi” Fier për vitin shkollor 2025-2026 mbështetet në bazën ligjore dhe dokumente të mëposhtme:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nenet 51-53;
- Udhëzimin e përbashkët nr. 20, datë 13.8.2025 “Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar”;
- Planin afatmesëm të shkollës 2022-2026;
- Akte të tjera nënligjore.

Hapi i parë për hartimin e planit vjetor fillon me raportin vjetor për vitin shkollor 2024-2025 dhe analizën e rezultateve të sesionit të parë të provimeve të Maturës Shtetërore, paralelisht me hartimin e e Kartës së Performancës së shkollës për vitin e kaluar.

Puna e kryer gjatë vitit në gjimnazin tonë për zbatimin e projektit “Qëndro në shkollë”, një projekt i shtrirë në shumë shkolla në vend me mbështetjen e qeverisë italiane dhe UNICEF Shqipëri, vlerësohet mjaft e suksesshme, duke shërbyer si pikë referimi për orientimin e hartuesve të planit vjetor.

Në datën 26.8.2024 në mbledhjen e këshillit të mësuesve u ngrit grupi i punës për hartimin e planit për vitin shkollor 2025-2026, i kryesuar nga drejtorja e shkollës dhe i përbërë nga anëtarët:

1. Artur Kasa, mësues
2. Elona Stefa, mësuese
3. Suela Hatija, prind
4. S.K., nxënëse

Plani si draft ka përfunduar në fund të muajit gusht 2025.

Në datën 4.9.2025 plani i hartuar iu paraqit kryetares së bordit të shkollës dhe u miratua.

Plani vjetor i shkollës i paraqitet për miratim ZVAP Fier, i parashikuar të zbatohet prej ditës së parë të vitit të ri shkollor, më 8.9.2025.

ANALIZA E GJENDJES

1. Ndjekja e IA-së (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).

Nga 425 nxënës në kontingjent në shtator 2024, deri në përfundim të vitit mësimor 2024-2025 u larguan 22 nxënës, e njëjta shifër si një vit më parë, por me një rritje të lehtë në përqindje (5,2% nga 4,9% të larguar në vitin 2023-2024, 8% në vitin 2022-2023, 12% në vitin 2021-2022). 31,8% e nxënësve të larguar nga shkolla jonë, emigruan jashtë vendit. 3 nxënës që janë transferuar në gjimnaze brenda qytetit (një në gjimnaz publik dhe në shkollë private) përbëjnë 0,7% të kontingjentit të fillimit të vitit shkollor; një vit më parë kishte 2 transferime drejt arsimit profesional, ndërsa në vitin shkollor 2022-2023 në gjimnaze brenda qytetit u transferuan 2% e kontingjentit të atëhershëm. 10 nxënës u përjashtuan për arsye mungesash (2,4% krahasuar me 1,6% një vit më parë dhe 0,6% para dy vitesh). 2 nxënës të tjerë lanë shkollën pa dhënë arsye. Në total ky grup nxënësish (të përjashtuar dhe të larguar pa arsye) përbëjnë 2,8% të kontingjentit të fillimit të vitit shkollor 2024-2025, ose +0,6% më shumë se një vit më parë, por përsëri nën nivelin shqetësues të para dy viteve (4%).

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 nxënësit kanë munguar mesatarisht në 2,45% të orëve mësimore nga 1,39% një vit më parë ose 1,58% para dy vitesh.

Pavarësisht se shifrat tregojnë tendencë negative, ende ky tregues është nën kontroll, duke pasur parasysh se vijon forcimi i disiplinës në evidentimin e mungesave në sistemin SMIP.

Anë e fortë:

Zbatimi i masave disiplinore për nxënësit që mungojnë pa arsye dhe ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë për evidentimin e mungesave kanë efekt në ndërgjegjësimin e nxënësve për frekuentimin e rregullt të shkollës.

Anë të dobëta:

Tendencë largimi i nxënësve për arsye të tjera që nuk lidhen me shkollën. Informimi i prindërve për mungesat e nxënësve nuk është i menjëhershëm, kontakti i mësuesve kujdestarë me prindërit vijon të jetë i ngadaltë.

2. Aspekti social

Gjimnazi ynë vijon mirëpret nxënës nga shtresat e marginalizuara, në kushte të pafavorshme sociale dhe nga kultura të ndryshme. Në hartën sociale 2024-2025 pasqyrohen 16 nxënës (4% e kontingjentit, 1% më e lartë se një vit më parë) nga familje në skemën e ndihmës ekonomike. 6 nxënës ishin jetimë me një prind. 14 nxënës ose 3% e kontingjentit vinin nga familje me prindër të divorcuar (1% më e ulët se një vit më parë). Pavarësisht riskut, nuk janë evidentuar

problematika tipike prej nxënësve të këtyre kategorive, falë edhe përkujdesjes nga ana e mësuesve dhe punës efektive prej oficerës së sigurisë dhe psikologes së shkollës.

Rreth 40% e prindërve të nxënësve ishin me nivel të ulët arsimor (arsim bazë, përmirësim krahasuar me 48% një vit më parë), 47% e tyre ishin me arsim të mesëm (2% më shumë se një vit më parë dhe në rritje), ndërsa me arsim të lartë ishin 13% nga 7% e prindërve një vit më parë. Një përqindje më e lartë, në rritje konstante, e prindërve me arsim të universitar, tregon edhe interesin e shtuar ndaj kësaj shkolle nga ana e prindërve me pretendime për rezultate të larta të fëmijëve të tyre. Megjithatë, përsëri vihet re se 87% e prindërve me nivel arsimor të ulët dhe të mesëm shfaq indiferencë ndaj aktiviteteve të shkollës, mosangazhim në vendimmarrjet e organizmave të saj dhe interes të dobët për frekuentimin e rregullt të fëmijëve të tyre. Në fillim të vitit të kaluar shkollor, në hartën sociale të shkollës u evidentuan 29 nxënës me talent në fusha të caktuara të artit, sportit (7% e kontingjentit, më pak se një vit më parë kur përbënin 14% të kontingjentit). Nxënës me vështirësi në të nxënë nuk janë evidentuar nga shërbimi psikosocial, por 5% e nxënësve është konsideruar nga shërbimi psikosocial si “shumë të dobët në mësim”. Në vitin 2024-2025 në gjimnazin tonë u regjistruan 5 nxënës nga komuniteti rom (2 nxënës romë u regjistruan një vit më parë, por vetëm njëri prej tyre vijoi në këtë gjimnaz). Ky ka qenë rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për të afruar nxënës të tjerë nga komuniteti rom, prej shkollave 9-vjeçare të afërta, por që jo gjithmonë kanë rezultuar të suksesshme.

Anë e fortë:

Nuk ka numër të lartë të nxënësve të kategorive problematike.

Anë e dobët:

Vihet re indiferencë nga prindërit e nxënësve që nuk frekuentojnë rregullisht.

3. Rezultatet e nxënësve

Në përfundim të vitit mësimor 2024-2025, rezulton se nota mesatare e nxënësve të gjithë shkollës për vitin shkollor është 7,25, më e ulët se dy vitet e fundit (7,78 në qershor 2024 dhe 7,65 në qershor 2023, (në qershor 2022 u raportua 7,5 dhe në qershor 2021 ishte 7,42). Kjo rënie vjen pas disa vitesh me tendencë të dukshme rritjeje, që ka qenë edhe arsyeja e përcaktimit të njërit objektiv për vitin shkollor 2024-2025.

Kalueshmëria e nxënësve të shkollës për këtë vit shkollor (statistikat e qershorit 2025) ishte 87,93% nga 93,6% në qershor 2024 dhe 94,4% në qershor 2025. Niveli i synuar në planin vjetor të vitit shkollor prej 95% nuk u arrit të realizohej për shkak të mbetjes në një ose dy lëndë të 27 nxënësve, 6 prej të cilëve maturantë. Shkaqe kryesore konsiderohen puna e dobët e mësuesve në pak lëndë, ku vihet re edhe numri më i lartë i nxënësve mbetës, largimet e nxënësve nga orët e këtyre lëndëve dhe zhvendosja e vëmendjes për disa muaj drejt përgatitjes për aktivitete të tjera (si p.sh. testimi PISA 2025).

Pas provimeve të klasës në sesionin e dytë kaluan në klasën pasardhëse edhe 40 nxënës të klasave X dhe XI, si edhe 5 maturantë, duke rritur kalueshmërinë e vitit shkollor në nivelin 92%.

Anë e fortë:

Janë evidentuar pikat e dobëta si shkak për mosrealizimet e vitit të kaluar dhe ka mësues të aftë e të përkushtuar për të ndryshuar situatën në drejtimin e duhur.

Anë e dobët:

Kalueshmëria dhe nota mesatare në fund të vitit mësimor, për shkak të mungesave në lëndë të caktuara, ndryshimeve në personelin mësimdhënës, është më e ulët se vitet e fundit.

4. Treguesit për të cilët shkolla ka arritjen më të mirë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.

Ende nuk është publikuar renditja e institucioneve arsimore në shkallë ZVA-je, në bazë të treguesve të kartës së performancës.

5. Etika dhe sjellja

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 ka pasur vetëm dy raste kur është aktivizuar komisioni i etikës dhe sjelljes për shqyrtim ankesash. Në njërin rast KES ka trajtuar një problematikë të ngritur nga oficerja e sigurisë mbi një grindje mes 4 nxënësve. Çështja kaloi në komisionin e disiplinës, i cili nuk dha masë disiplinore, meqenëse këta nxënës nuk kanë shfaqur më parë probleme të sjelljes. Në rastin e dytë ankesa në KES u drejtua nga një mësuese mbi sjelljen problematike të katër nxënësve. KES, pasi shqyrtoi ngjarjen, vendosi të mos ta përcjellë rastin në komisionin e disiplinës, duke i këshilluar nxënësit. Në të dyja rastet, nxënësit u mbajtën në vëzhgim dhe nuk paraqitën problematika deri në fund të vitit shkollor.

Anë e fortë:

Shkolla ka një oficerie sigurie aktive gjatë kohës së funksionimit të shkollës, e cila ka bashkëpunim të plotë me mësuesit dhe strukturat e policisë.

Anë e dobët:

Nuk evidentohet problematikë.

6. Arritjet në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në sesionin e parë në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2025 u shënuar rënie në treguesit e cilësisë krahasuar me shifrat e MSH 2024. Në provimet e detyruara kalueshmëria, sipas përlllogaritjes së kartës së performancës rezulton 93,64%, mjaft më e ulët se një vit më parë ose - 5,85% (99,49% në KPSH 2024 dhe 99,25% në KPSH 2023). Në përfundim të sesionit të parë të MSH kalueshmëria rezulton 82% nga 95% (duke pasur parasysh se nxënësit mbetës në provime

të ndryshme janë të ndryshëm), ndërsa rezultatet e sesionit të dytë nuk janë shpallur ende nga QSHA.

Në sesionin e parë në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë kaluan 94,85% e nxënësve më e ulët se niveli prej 100% një vit më parë dhe 98,5% para dy vitesh, me notë mesatare 7,34 (vjet ishte 7,6). Në provimin e matematikës kalueshmëria në qershor ishte 86,8%, ku u regjistrua edhe numri më i lartë i mbetësve (18 maturantë) me pasojë rënien e treguesit të kalueshmërisë dhe cilësisë në të gjithë shkollën (një vit më parë kaluan 100%). Nota mesatare, e diktuar edhe nga numri shumë i lartë i mbetësve në provimin e matematikës, ishte 5,31, në rënie të dukshme nga niveli prej 7,29 dhe 6,4 në dy vitet e fundit. Ndërsa në provimin e gjuhës angleze në qershor kaluan mbi 99,3%, i vetmi provim ku ka rritje krahasuar me shifrën 98,5% të një viti më parë. Nota mesatare në provimin e gjuhës së huaj ishte 7,71, përsëri me rritje nga mesatarja 7,41 e vitit të kaluar. Nota mesatare e tri provimeve të detyruara në sesionin e parë të MSH 2025 ishte 6,53 nga 7,35 në qershor 2024. Në provimin me zgjedhje kalueshmëria është në nivelin 98,5% nga 100% e vitit 2023-2024, por përsëri më e lartë se para dy vitesh (96,2% në qershor 2023). Nota mesatare në provimet me zgjedhje ishte 7,5, më e ulët se në qershor 2024 (7,76), por përsëri më e lartë se në qershor 2023 (6,8).

Shkaqet lidhen, si edhe në treguesit e kalueshmërisë dhe cilësisë në përgjithësi në të gjitha klasat, me ndryshimet në personelin mësimdhënës të shkollës, për shkak të largimit të disa mësuesve, ose punës me ngarkesë të pjesshme në këtë shkollë. Këtyre arsyeve iu shtohen edhe mospërgatitja e maturantëve për situata problematike që lidhen me administrimin, si në rastin e provimit të matematikës, ku u shënua edhe një numër shumë i lartë i maturantëve mbetës.

Gjatë vitit shkollor 2024-2025, pas përgatitjes vitin e kaluar për testimin ndërkombëtar PISA Field Trial, vijoi me intensitet përgatitja për vlerësimin kryesor PISA Main Test 2025, me planin e hartuar në tetor 2024. Për këtë testim shumë të rëndësishëm ndërkombëtar në periudhën 10 shkurt – 21 prill janë zhvilluar simulime intensive të përditshme në grupe me modelet e testit nga uebsajti i OECD-së. Pjesëmarrja e të gjithë nxënësve të klasave X (më tepër se shifra e përcaktuar, 81 nxënës) dhe rezultatet e simulimeve, me përmirësim të ndjeshëm nga seancat fillestare, konsiderohen një sukses duke pasur parasysh se shkolla nuk disponon infrastrukturën digjitale të nevojshme. Në datën 22.4.2025 u zhvillua testimi ndërkombëtar PISA 2025 me grupin prej 45 nxënësish, të caktuar me kampionim nga organizatorët. Por, rezultatet e këtij vlerësimi nuk janë bërë ende të njohura.

Anë e fortë:

Ka mundësi reale për përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e kalueshmërisë dhe të notës mesatare vjetore në tërësi në provimet e maturës, pasi personeli mësimdhënës është i motivuar për ndryshim.

Anë e dobët:

Ka rënie të cilësisë në provimet e MSH, ku evidentohet mangësi në përgatitjen e maturantëve për plotësimin e testit.

7. Mësuesit: përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.

Gjatë vitit mësimor 2024-2025 nuk ka pasur mungesa të mësuesve brenda një dite pune. Në 183 ditë mësimore të vitit shkollor 2023-2024 ka pasur 93 ditë mungesa nga ana e mësuesve, ose 1,69% e totalit (5490 ditë pune, për 30 mësues, duke marrë parasysh se dy prej tyre kanë pasur $\frac{1}{2}$ e normës mësimore në këtë shkollë), ose 3,1 ditë pune mungesë për çdo mësues. Krahasuar me një vit më parë ky tregues ka përmirësim të lehtë (një vit më parë ishte 1,93% e totalit ose 3,5 ditë të munguara për çdo mësues). Mësuesit kryesisht kanë munguar për arsye shëndetësore, vërtetuar me raport mjekësor.

Në vitin shkollor 2024-2025 dy mësuese kaluan testin e kualifikimit profesional me rezultatin “Shumë mirë”, ndërsa gjashtë mësues u kualifikuan për shkallën e parë dhe të dytë me rezultatin “Shkëlqyeshëm” (5 mësues) dhe “Shumë mirë” (1 mësues). Gjatë vitit shkollor 2024-2025 nga mësuesit e shkollës janë ndjekur 53 programe trajnimi të certifikuara me kredite në sistemin e RASH-it dhe janë përfituar 500 kredite (50 kredite sipas sistemit të vjetër, përdorur pjesërisht në vitin 2024), ose 16,6 kredite për mësues. 26 mësues nga 30 ndoqën të paktën një program trajnimi gjatë vitit shkollor 2024-2025.

Anë e fortë:

Nivel i lartë i disiplinës në punë dhe angazhimit të personelit.

Anë e dobët:

Jo të gjithë mësuesit vijnë kualifikimin profesional nëpërmjet trajnimeve.

8. Pjesëmarrja në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 nxënësit tanë nuk morën pjesë masivisht në fazën e parë dhe të dytë të olimpiadave kombëtare, ku nuk pati edhe fitues të çmimeve që ndan ZVAP Fier nga shkolla jonë.

Ndërsa në aktivitete të tjera të organizuara midis shkollave të arsimit të mesëm të lartë nga Bashkia Fier në bashkëpunim me ZVAP Fier, pjesëmarrja e nxënësve të gjimnazit “Perikli Ikonomi” ka qenë e qëndrueshme, duke ruajtur ritmin e fitoreve që renditen në vijim:

- *Krosi i vjeshtës 2024: 2 vende të para për djem (klasa XI, nxënësi A.V. dhe XII, nxënësi E.Xh.).*
- *Krosi i vjeshtës 2024: 1 vend i dytë për vajza (klasa X, nxënësja A.H.).*
- *Krosi i vjeshtës 2024: 1 vend i tretë për vajza (klasa X, nxënësja A.C.).*
- *Kampionati i shahut për vajza. Vendi i tretë (klasa XII, E.L.).*
- *Kampionati i shahut për djem. Vendi i katërt (klasa XII, E.D.).*
- *Kampionati i basketbollit për vajza: Vendi i parë.*
- *Kampionati i futbollit për djem: Vendi i dytë.*
- *Kampionati i volejbollit për djem: Vendi i katërt.*
- *Kampionati i volejbollit për vajza: Vendi i tretë.*

Ky tregues shënon rënie me 10 çmime të fituara, që vlerësohen me 36 pikë në kartën e performancës së vitit 2024-2025 (nga 22 vende dhe 76 pikë në kartën e performancës 2023-2024).

Por, përsëri shkolla jonë nuk ka humbur vendin e saj në renditjen mes shkollave të tjera për këtë tregues, krahasuar me një vit më parë (e pesta nga shkollat AML në ZVAP Fier, e dyta ndër shkollat AML publike).

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 ka vijuar bashkëpunimi me KOKSH-in për projektin “Ekipet sportive në shkolla” me krijimin dhe aktivizimin e dy ekipeve të basketbollit.

Anë e fortë:

Nxënësit e shkollës sonë ruajnë nivelin e sukseseve në aktivitetet sportive.

Anë e dobët:

Ende nuk është konsoliduar puna e diferencuar me talentet nëpërmjet klubeve shkencore.

9. Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.

Për vlerësimin e shkollave, ZVA Fier ka zhvilluar në muajin maj 2025 pyetësorët e kartës së performancës me nxënës, prindër dhe mësues të shkollës.

Perceptimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të gjimnazit tonë rezulton të jetë si vijon:

- Në total janë 99,9% e nxënësve shprehur se “janë plotësisht dakord” (96,9% nga 97,4% vitin e kaluar) ose “dakord” (3,1%) mbi cilësinë e shkollës. Ky nivel krahasohet me 99,7% në pyetësorin e vitit të kaluar ose 87,4% para dy vitesh.
- Dy nxënës që janë shprehur në mënyrë të rezervuar (“Pjesërisht dakord”), kanë pasur vërejtje mbi kushtet në shkollë (ku problem mbetet ngrohja) ose përdorimin e pamjaftueshëm të burimeve didaktike digjitale në mësimdhënie nga mësuesit (që lidhet edhe me mungesën e laboratorëve TIK). Për pohimin “*Mjedisi ku mësoj ka kushte fizike të përshtatshme (ngrohje, ujë, higjienë, ndriçim)*” 73% e nxënësve të tjerë janë shprehur “plotësisht dakord”, ndërsa për pohimin “*Mësuesit përdorin burime dhe mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë dhe për të përmirësuar arritjet e mia*” me shprehjen “plotësisht dakord” kanë dhënë vlerësimin 99% e nxënësve.
- 100% e nxënësve janë shprehur “plotësisht dakord” ose “dakord” kur pyeten mbi përkrahjen dhe trajtimin e drejtë e të barabartë të mësuesve dhe personelit ndaj tyre.
- 100% janë shprehur pozitivisht (95% “plotësisht dakord” dhe 5% “dakord”) se ndihen të sigurt në mjediset e shkollës.
- 100% e nxënësve janë shprehur me alternativën “plotësisht dakord” për pohimin “*Më pëlqen të mësoj në këtë shkollë*”.

Anë e fortë:

Shumica e nxënësve mendojnë pozitivisht për personelin mësimor, cilësinë dhe sigurinë në shkollë.

Anë e dobët:

Një pjesë e nxënësve shprehin jo entuziastë me të drejtë për infrastrukturën e shkollës (kryesisht mungesën e ngrohjes).

SYNIMI

Synimi ynë lidhet me dy përparësitë në planin afatmesëm të shkollës: *“Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera”* dhe *“Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës”*.

Për vitin shkollor 2025-2026 synimi ynë do të jetë:

“Konsolidimi i imazhit pozitiv për shkollën tonë nëpërmjet qëndrueshmërisë dhe rritjes cilësore, për t’u kthyer në shkollën ku nxënësit realizojnë ëndrrat dhe dëshirat”.

Vlerësojmë se, nisur nga përparësitë e planit afatmesëm dhe analiza e vitit shkollor 2024-2025, niveli i ulët i kalueshmërisë në të gjitha klasat cenon qëndrueshmërinë dhe përbën një nga arsyet e largimeve drejt shkollave të tjera, sidomos atyre private. Rezultatet e ulëta në provimet e maturës kërkojnë vëmendje të veçantë dhe veprime serioze për korrigjimin e tyre në fund të vitit shkollor 2025-2026.

Mbi këtë bazë përcaktojmë për vitin shkollor 2025-2026:

OBJEKTIVAT

1. Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2026) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë 94% nga niveli prej 87,9% i vitit të kaluar.
Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore 2026 përqindja e maturantëve kalues të rritet në 90% nga niveli prej 82% (112 maturantë nga 137) i një viti më parë.

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për realizimin e objektivave planifikohen këto veprimtari:

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Produkti	Afati
Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2026) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë 94% nga niveli prej 87,9% i vitit të kaluar.	1	Analizë për të përcaktuar lëndët ku ka pasur dobësi	Secili mësues	Raport	Nëntor 2025
	2	Hartimi i një plani ndërhyrjeje për ndryshimin e gjendjes në pikat e dobëta të konstatuara	Drejtoria	Plan	Dhjetor 2025
	3	Takime me prindër të nxënësve që rrezikojnë të mbeten në klasë	Secili mësues kujdestar	Procesverbal	Shkurt 2026
	4	Raportim në drejtori për nivelin e arritjeve të nxënësve të rrezikuar për të mbetur në klasë	Secili mësues kujdestar	Raport	Mars 2026
	5	Analizë e numrit të mungesave 1-3 orëshe, si një shkak për të mbetur në klasë	Nëndrejtori	Raport	Prill 2026
	6	Takim pune me mësuesit e lëndëve ku parashikohet kalueshmëri e ulët	Drejtoria		Maj 2026
Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore 2026 përqindja e maturantëve	1	Analizë e notave mesatare të arritura në përfundim të periudhës së parë dhe të dytë për secilin maturant	Mësuesit kujdestarë të klasave XII	Raport	Dhjetor 2026 Prill 2026

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Produkti	Afati
kalues të rritet në 90% nga niveli prej 82% (112 maturantë nga 137) i një viti më parë.	2	Seanca orientuese me maturantët mbi përcaktimin e lëndës me zgjedhje në provimin e maturës, njohja me vështirësitë e lëndës, aftësitë e shfaqura dhe nevojat e secilit prej tyre për të arritur rezultatin e kërkuar	Mësuesit e lëndëve me zgjedhje (fizikë, kimi, biologji, ekonomi, histori, psikologji, etj.)	Plan	Janar 2026
	3	Plan ndërhyrjeje për sigurimin e kalueshmërisë për maturantët e nivelit të notave 4 – 5 – 6	Mësuesit e gjuhës shqipe e letërsisë, matematikës	Plan	Shkurt 2026
	4	Konsultime me maturantët për të gjitha lëndët e provimeve të maturës	Mësuesit e lëndëve provim mature	Plan	Mars-maj 2026

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për vëzhgimin e zbatimit të planit gjatë vitit shkollor 2025-2026 ngarkohet grupi i punës i përbërë nga:

1. Natasha Mino, drejtore
2. Anila Ikonimi, mësuese
3. Arnisa Shehu, përfaqësuese e komunitetit
4. Anajada Shyti, prind
5. Suela Hatija, prind

Nr.	Veprimtaria vëzhguese	Afati
1	Relacion për realizimin e veprimtarive mbi objektivat e planit	Dhjetor 2025 Mars 2026 Maj 2026
2	Pjesëmarrje në seancat orientuese, konsultimet, takimet e punës	Sipas grafikut, njoftohet nga drejtoria
3	Pyetësor me maturantët me arritje mesatare mbi nivelin e asistencës që marrin nga mësuesit për eliminimin e vështirësive që kanë për arritjen e rezultateve më të larta	Prill 2026
4	Shqyrtim i rezultateve të paraprovimeve në lëndët e maturës	Maj 2026

BUXHETI

Nuk parashikohet buxhet për realizimin e objektivave të planit vjetor 2025-2026.